

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Këlliçi: Betimet e Ramës se ai nuk ka vjedhur, në fakt provojnë të kundërtën
ADRESA	https://a2news.com/shqiperia/politike/kellici-betimet-e-rames-se-ai-nuk-ka-vjedhur-ne-fakt-provojne-i1185963
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 18:21:20 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 18:14:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c9cce960cdc9ed786fa5178fc21e493d21b737df6b1f026a2dfd79625de8486
TEKSTI	7eae52390dbfc97dc3387df154a629b8fb0318f48153bd1d0268cc2813cff675
PAMJA	4a3935c9f281379964aaca468bc903c4f2f249e3e61d562fc7162c3c5bafb13d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1bf9cb93c0c0cb66661f303d5589f6c3fad33b36ab23c6d26873015be7a1bcde
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b1c7a27947b4cc546e59bf39e541eaf49f294f8d53ee0afce777d7f589624631
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1bf9cb93c0c0cb66661f303d5589f6c3fad33b36ab23c6d26873015be7a1bcde>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Këlliçi: Betimet e Ramës se ai nuk ka vjedhur, në fakt provojnë të kundërtën



Nga A2 CNN

27 Shtator 2026, 20:14 | Politikë



Nënkryetari i Partisë Demokratike, Belind Këlliçi, i cilësoi "përçarje" deklaratat e kryeministrit Edi Rama nga Rinas dhe theksoi se ato lidhen me gjërat që kanë ndodhur, sipas tij, në Nju Jork.

"Edi Rama i thirri gazetarët në Rinas për një konferencë të jashtëzakonshme shtypi, por, i frikësuar nga pyetjet, iu kthye monologut të zakonshëm. Foli si një jerm për armiq të brendshëm dhe sukseset e mëdha që, sipas tij, këta armiq i pengojnë. Përçarja e Ramës lidhet edhe me atë që ndodhi në New York: foli për inteligjencën artificiale dhe akuzoi popullin e tij si antisemit, në një sallë krejt të boshatisur, ndërsa Vuçiçi ia la fjalën për Kosovën. Atje u prit me protesta, duke nisur nga takimi i parë në Michigan, dhe pas bojkotit total, takimet e vetme që realizoi janë ato me Taulant Ballën dhe Pjerin Ndreun. U kthye nga New York, ku e pritën me protesta dhe përcimim pas shpenzimeve përrallore, të denja vetëm për kreun e një Narkoshteti. Fjalimi i tij për Diellën, i shkruar nga ChatGPT, ngjalli neveri. I rënduar nga barra e çështjeve që rrethojnë qeverisjen e tij, në vend që të dilte përpara gazetarëve, siç kishte njoftuar, u struk në një monolog të turpshëm. Motoja e tij ishte: "Mos kujtoni se ju kam vjedhur". Në monologun e tij të vetposhtërimit, Padrino bëri avokatinë e Viora Hysenit, kësaj zyrtareje pa moral, pa dinjitet dhe pa atdhe, që u emërua në atë detyrë të besimit më të lartë shtetëror, në kundërshtim me çdo kriter e parim. Merita e vetme e saj ishte shkarkimi nga autoritetet e Kosovës për grabitje dhe dorëzim në Beograd, të të dhënave të Shërbimit Informativ të Kosovës", tha Këlliçi, shkruan A2.

Sipas nënkryetarit demokrat, "betimet e tij se ai nuk ka vjedhur, në fakt provojnë të kundërtën".

"Ti, Edi Rama, je njeriu që ke shkarkuar në mënyrë antikushtetuese kryetaren e ILDKP-së, sapo ajo nisi hetimin për pallatin pesëkatësh të bashkëshortes tënde, të marrë në pajë: një ndërtesë pa fatura doganore, tatimore, bankare apo ndërtimore, e ngritur nga një kompani që fitoi qindra milionë euro në tendera.

Ti, Edi Rama, je njeriu që, në shkelje të Kushtetutës, shkarkove kryetaren e ILDKP-së, sapo ajo nisi hetimin për sarajet e tua: me themele 57 metra të gjata dhe park prej 8,300 metrash katrorë, më të mëdha se Pallati Presidencial, të ndërtuara në një kohë kur ti kishe deklaruar vetëm 3,800 euro dhe 400 mijë lekë kursime.

Ti, Edi Rama, je njeriu që je akuzuar në një raport zyrtar të OSBE-së të vitit 2014 për 200 milionë euro të fshehura në banka offshore.

Ti, Edi Rama, je njeriu që ke firmosur personalisht dhënien e 130 milionë eurove për inceneratorin e Tiranës, tetë muaj përpara se të themelohej kompania së cilës ia dhe.

Ti, Edi Rama, je njeriu që je akuzuar drejtpërdrejtë, për transportimin jashtë vendit, me avionin tënd, të qindra valixheve me euro, por refuzove ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar.

Ti, Edi Rama, je kryehajduti i shqiptarëve, më i madhi i të gjitha kohërave, autori i vërtetë i koncesioneve të sterilizimit, Check-Up-it dhe analizave, përmes të cilave, së bashku me ministrat e tu, keni vjedhur të paktën 300 milionë euro.

Ti je hajduti që, së bashku me Alabari-n tënd, ke vjedhur trual publik me vlerë 3 miliardë euro në Portin e Durrësit

TE FUNDIT

Banesa përfshihet nga flakët, humb jetën i moshuari në Fier

🔴 Tirana i bën kërkesën FSHF-së, derbi i kryeqytetit mund të shtyhet. Shkak bëhet Kombëtarja

🔴 Të pathënat e jetës së Alket Rizait, mes burgut e arratisjeve

Aksidenti i rëndë në Cërrik, humb jetën një i ri dhe plagoset një i mitur

MË TË VIZITUARAT

Formacionet zyrtare të ndeshjes Austri-Kosovë, Zhegrova në stol

Pas fitores me Bjellorusinë, kuqezinjët vijojnë përgatitjet për duelin ndaj S...

Kina merr timonin në tregun e veturave elektrike në Kosovë

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Ti, Edi Rama, je kryehajduti i shqiptarëve në tërë historinë e tyre. Për të shkatërruar përfundimisht sistemin e prokurimeve, ke shpikur modelin "KAYO": me të cilin mallrat e blera me paratë e taksapaguesve ia shesin qeverisë tënde të korruptuar, dhe fitimin e ndajnë me ty", u shpreh më tej Këlliçi.

(A2 Televizion)

A2 CNN **Livestream**

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Kërkon kandidatët për bashkitë, Berisha pritët të ndryshojë edhe drejtuesit politikë



Koincidenca në Rinas. Berisha u nis drejt Strasburgut, Rama erdhi nga SHBA



Distancohet nga Vlora Hyseni, Rama mbron veten: Jam këtu për histori, jo për pasuri



Tabaku: Shqipëria nuk vuan nga një "republikë prokurorësh", por nga një republikë të korruptuarish




Hetimi ndaj Vlora Hysenit, Rama: Përgjegjësi individuale me drejtësinë, nuk provon se qeveria është e korruptuar



"Nuk kam prekur kurrë paratë e shqiptarëve", Rama: S'ka asnjë provë që kam përdorur pushtetin

Latest Videos



“A i ke fikur radarët?” Skandali SHISH, zbulohet çfarë kanë kërkuar shqiptarët në internet: Mosha e



“Mund t'i ndërtojmë në Shqipëri” Kërkojnë ujë, energji pse po debatohet kaq për qendrat e të dhënave?



“12% mundësia për katastrofë” liderët botërorë debat për Inteligjencën Artificiale: Duhet ta ndalim!



AI nis “dezertimin”, sulmohet faqja qeveritare, reagon kryeministri: Open AI të japë llogari

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi
Sociale
Kulturë
Moti

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë
Kronikë
Aktualitet

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim

Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë
Lumi i kokainës
Ditari ndërkombëtar
Zbulio
Imagjinatë
Dëshmi



Live TV

Rreth nesh Kushtet e Privatësisë Karriera Kontakt

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediodesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.